

## NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

**“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”**

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Konceptin e letërnjoftimit digjital, si një nga format e letërnjoftimit të shtetasve shqiptarë;
- Pritshmëritë nga pajisja me këtë letërnjoftim, bashkë me fushat e përdorimit.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 30 prill 2024 deri më 29 maj 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: [Sara.Shameti@mb.gov.al](mailto:Sara.Shameti@mb.gov.al)

## Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: [Sara.Shameti@mb.gov.al](mailto:Sara.Shameti@mb.gov.al)

Znj. Silvi Tola - Specialiste, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator e-mail: [Silvi.Tola@mb.gov.al](mailto:Silvi.Tola@mb.gov.al)

## Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Projektakti është konsultuar me punonjësit e IdentiTek sh.a dhe punonjësit e Ministrisë së Brendshme.

## Sfondi i propozimit legjislativ

Ky projektligj synon krijimin e mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital (e-letërnjoftim) për të gjithë shtetasit e pajisur me letërnjoftim elektronik, në zbatim të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”, me qëllim përmbushjen e agjendës politike të qeverisë shqiptare, në kuadër të digjitalizimit, modernizimit të sistemeve elektronike, si dhe zbatimin e skemave të sigurta të shërbimeve e-ID. Pajisja me letërnjoftim digjital (e-letërnjoftim) ka për qëllim përmirësimin dhe standardizimin e mënyrave të identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital.

## Propozimet

Nevoja për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”, është në përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, përkatësisht Rregulloren e Be nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 23 korrik 2014, “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm”. Në vitin 2024, Bashkimi Evropian (BE) zbatoi një rregullore të re për identitetin digjital, e cila ka synuar të përmirësojë dhe standardizojë mënyrat e identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital. Identiteti digjital, si një mjet që mundëson njohjen e një personi në ambientin digjital, përfshin informacione personale, si emrin, datën e lindjes, adresën, dhe të tjera të dhëna të rëndësishme, duke krijuar mundësinë e sigurimit të një përputhje të lartë të standardeve dhe sigurisë në të gjithë vendet anëtare, për të lehtësuar lëvizjen dhe komunikimin nëpërmjet platformave dixhitale brenda BE-së dhe për të forcuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë arsye, miratimi i këtij projektligji, do të përmbushë objektivat e qeverisë në drejtim të identitetit digjital, duke standardizuar identifikimin e qytetarëve në nivel evropian dhe implementuar një identitet digjital të përbashkët, i cili mund të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet dhe bizneset evropiane. Gjithashtu, një identitet digjital i përbashkët gjithashtu mund të ndihmojë në luftën kundër krimit të organizuar dhe mashtrimeve

në internet, duke rritur sigurinë dhe besueshmërinë e transaksioneve online. Ministria e Brendshme, e në veçanti shoqëria aksionare IdentITek, si shoqëria e cila prodhon dhe shpërndan dokumente biometrike për shtetasit shqiptarë dhe/ose shtetasve të huaj me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, sjellin këtë propozim në përputhje me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë, në tërësi, si dhe në përmbushje të kompetencave sipas vendimit nr. 80, datë 14.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”.

## Pyetjet

*Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.*

- Si mendoni se mund të ndikojë pajisja edhe me letërnjoftim digjital për shtetasit shqiptarë?